



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

REPublika e Kosovës - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO		
Oda e Infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës Komora medicinskoh sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova Chamber of nurses, midwives and other health professionals of Kosovo		
ARRIVY ARRIVY ARCHIVE		
Nr. Prot Broj. prot Prot. no	Nr. I faq. Br. str. No. page	Data: Datum: Date:
150		02.08.2026
PRISTINE - PRISTINA - PRISHTINA		

Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës
Komora medicinskoh sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals

KUVENDI I ODËS SË INFERMIERËVE, MAMIVE DHE PROFESIONISTËVE TË TJERË SHËNDETËSORË TË KOSOVËS (OIK) në mbështetje të nenit 19, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë nr. 04/L-150, nenit 17, paragrafi 4 dhe nenit 18, paragrafi 2 të Statutit të OIK, si dhe nenit 58 të Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të organeve të OIK, në mbledhjen e mbajtur më 27.02.2026, miraton këtë:

RREGULLORE ZGJEDHORE

PËR EMËRIMIN, PËRBËRJEN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE DHE KOMISIONIT TË NJËSIVE ZGJEDHORE

Neni 1

Qëllimi dhe përkufizimet

1. Kjo Rregullore përcakton procedurat për themelimin, përbërjen dhe përgjegjësitë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si dhe të Komisioneve të Njësive Zgjedhore, kriteret për emërimin e anëtarëve të Komisioneve të Njësive Zgjedhore, zëvendësimin, shkarkimin dhe përfundimin e mandatit, të drejtat dhe detyrat e anëtarëve, si dhe rregullat për funksionimin, orarin e punës, mbledhjet, procedurën e zhvillimit të mbledhjeve, vendimmarrjen, konfliktin e interesit dhe dokumentacionin.
2. Shkurtesat dhe termat e përdorur në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:
 - 2.1. **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)** – organi i përhershëm i OIK përgjegjës për organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit zgjedhor të organeve të OIK;
 - 2.2. **Komisioni i Njësive Zgjedhore (KNJZ)** – komisioni i themeluar për administrimin dhe organizimin e zgjedhjeve në kuadër të njësisë zgjedhore;
 - 2.3. **Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (SKQZ)** – shërbimi administrativ i KQZ-së që ofron mbështetje administrative dhe logjistike për realizimin e procesit zgjedhor;
 - 2.4. **Vendvotim** – vendi/hapësira e caktuar për zhvillimin e procesit të votimit në kuadër të njësisë zgjedhore.

Neni 2

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organ i përhershëm i OIK me mandat katër (4) vjeçar, për organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit zgjedhor të organeve të OIK.
2. KQZ vepron në selinë e OIK.
3. KQZ ka vulën e saj; përmbajtja, forma, dimensionet dhe mënyra e përdorimit të vulës përcaktohen me vendim të KQZ-së.
4. KQZ mban protokoll të veçantë.

Neni 3

Përbërja dhe mandati i KQZ-së

1. KQZ përbëhet nga pesë (5) anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi i OIK, me propozim të Këshillit Drejtues.
2. Anëtarët e KQZ-së kanë mandat katër (4) vjeçar nga dita e zgjedhjes së tyre dhe deri në përfundimin e procedurës së zgjedhjes së anëtarëve me mandat të ri. Emërimi i KQZ-së bëhet njëkohësisht me vendimin për shpalljen e zgjedhjeve.
3. Deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj të KQZ-së, anëtarët e mandatit ekzistues i ushtrojnë kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre.
4. Anëtarët e KQZ-së nuk mund të jenë kandidatë për anëtarë të organeve të OIK që zgjidhen me kandidim në Kuvend.
5. Anëtarët e KQZ-së nuk mund të mbështesin me nënshkrim asnjë kandidat për anëtar të Kuvendit të OIK.

Neni 4

Kompetencat dhe përgjegjësitë e KQZ-së

1. KQZ, në pajtim me këtë Rregullore dhe legjislacionin zgjedhor, ka këto përgjegjësi:
 - 1.1. siguron përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve dhe shkarkimit në pajtim me Statutin e OIK dhe këtë Rregullore;
 - 1.2. përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve dhe shkarkimin e anëtarëve të organeve të OIK;
 - 1.3. përgatit dhe miraton Planin e Veprimit dhe përcakton detyra të veçanta;
 - 1.4. përcakton afatet kohore për ekzekutimin e Planit të Veprimit dhe monitoron zbatimin e tij;
 - 1.5. emëron komisionet e njërive zgjedhore;
 - 1.6. mbikëqyr punën e KNJZ-ve dhe veprimet përgatitore në procesin zgjedhor;
 - 1.7. zbaton përshtatshmërisht dispozitat ligjore dhe procedurat për realizimin e zgjedhjeve të Kuvendit të OIK edhe për organet e tjera, kur është e aplikueshme;
 - 1.8. vendos në shkallë të parë për ankesat në procesin zgjedhor;
 - 1.9. miraton formën dhe dizajnin e fletëvotimit;
 - 1.10. certifikon Listën Votuese;
 - 1.11. certifikon kandidatët për organet e OIK;
 - 1.12. certifikon rezultatin zgjedhor dhe shqyrton ankesat zgjedhore të parashtruara nga palët;
 - 1.13. trajnon KNJZ-të dhe siguron materialin zgjedhor;
 - 1.14. verifikon listat iniciuese për ngritjen e procedurës së shkarkimit të anëtarëve të Kuvendit (kur është e aplikueshme);

1.15. me votën e 2/3 të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, mund të bëjë plotësim/ndryshim të rregulloreve që shërbejnë si anekse të kësaj Rregulloreje (kur kjo kompetencë i është deleguar KQZ-së);

1.16. është i vetmi autoritet që prononcohet dhe deklarohet për procesin zgjedhorë apo autorizon personat tjerë për këtë deklaram

1.17. nxjerr akte të tjera dhe kryen detyra të ndryshme për realizimin e zgjedhjeve të organeve të OIK, në përputhje me këtë Rregullore dhe Statutin e OIK;

1.18. çështjet që nuk janë të përcaktuara shprehimisht me këtë Rregullore apo aktet e tjera të OIK rregullohen me vendime të posaçme të KQZ-së, në frymën e kësaj Rregulloreje;

1.19. çështjet e mbarëvajtjes së punës së KQZ-së rregullohen përshtatshëmrisht me Rregulloren për punën e organeve kolegjiale të OIK.

Neni 5

Kompetencat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të KQZ-së

1. Anëtarët e KQZ-së kanë këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - 1.1. kujdesen për zbatimin e kësaj Rregulloreje dhe akteve të nxjerra nga KQZ;
 - 1.2. marrin pjesë në mbledhjet e KQZ-së dhe japin propozime lidhur me çështjet që trajtohen;
 - 1.3. kryejnë detyra të përcaktuara nga KQZ dhe ndërmarrin veprime sipas Planit të Veprimit;
 - 1.4. propozojnë plotësimin dhe ndryshimin e rendit të ditës;
 - 1.5. njoftojnë kryesuesin dhe arsyetojnë mungesën në mbledhje;
 - 1.6. vetëdeklarohen dhe përmbahen nga votimi në rast dyshimi për konflikt interesi;
 - 1.7. kryejnë edhe detyra të tjera në frymën e kësaj Rregulloreje, të caktuara nga Kryesuesi i KQZ-së.
2. Anëtari i KQZ-së është i obliguar që mungesën e tij në mbledhjen e radhës të arsyetojë. Në rast të tri (3) mungesave të paarsyeshme, KQZ mund t'i propozojë organit kompetent përfundimin e mandatit.

Neni 6

Kryesuesi i KQZ-së

1. Kryesuesi i KQZ-së zgjidhet nga Kuvendi, me propozim të Këshillit Drejtues.
2. Kryesuesi i KQZ-së ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - 2.1. përfaqëson KQZ-në;
 - 2.2. thërret mbledhjet e KQZ-së dhe propozon rendin e ditës;
 - 2.3. kryeson mbledhjet dhe kujdeset për mbarëvajtjen e tyre;
 - 2.4. kujdeset për zbatimin e drejtë të kësaj Rregulloreje, vendimeve dhe akteve të KQZ-së, si dhe akteve normative të OIK brenda fushëveprimit të KQZ-së;
 - 2.5. siguron transparencën e akteve që nxjerr KQZ-ja;
 - 2.6. nënshkruan vendimet dhe aktet e miratuara nga KQZ-ja;
 - 2.7. ndërmerr veprime të tjera të nevojshme për funksionalitetin e KQZ-së.
3. Në rast të pamundësisë së ushtrimit të kompetencave të kryesuesit, ato ushtrohen nga zëvendëskryesuesi.

Neni 7

Zëvendëskryesuesi i KQZ-së

1. Zëvendëskryesuesi i KQZ-së zgjidhet nga radhët e anëtarëve të KQZ-së, me propozim të kryesuesit të KQZ-së.
2. Zëvendëskryesuesi zgjidhet me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të KQZ-së.
3. Zëvendëskryesuesi i ushtron kompetencat e kryesuesit në rast të mungesës së tij.
4. Në mungesë të kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit, mbledhjet i kryeson anëtari më i vjetër në moshë nga radhët e anëtarëve të KQZ-së.

Neni 8

Mbledhjet e KQZ-së

1. Gjatë procesit zgjedhor, KQZ mban mbledhje të rregullta të paktën një (1) herë në javë, nga shpallja e zgjedhjeve. Jashtë procesit zgjedhor, mbledhjet thirren sipas nevojës.
2. Mbledhjet e rregullta i thërret kryesuesi me propozim të rendit të ditës.
3. Rendi i ditës dhe materiali përcjellës u dërgohen anëtarëve së bashku me ftesën për mbledhje.
4. Ftesa dhe materiali duhet të dërgohen së paku njëzet e katër (24) orë para mbledhjes.
5. Në pamundësi të kryesuesit, mbledhjen e rregullt mund ta thërrasë zëvendëskryesuesi. Mbledhjet e jashtëzakonshme mund të thirren me kërkesën e të paktën tre (3) anëtarëve të KQZ-së.
6. Detyrimet e paragrafëve 3 dhe 4 nuk zbatohen për mbledhjet e jashtëzakonshme.
7. Për të gjitha mbledhjet përpilohen procesverbale, të cilat ruhen në arkivin e KQZ-së. Procesverbali miratohet në mbledhjen pasuese.
8. Për çështjet që nuk janë paraparë me këtë Rregullore, zbatohen dispozitat e Rregullores për punën e organeve kolegjiale të OIK.

Neni 9

Kuorumi dhe vendimmarrja

1. KQZ ka kuorum kur janë të pranishëm shumica e anëtarëve të saj.
2. Para çdo vendimmarrjeje, kryesuesi i mbledhjes konstaton kuorumin.
3. Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të votave, nëse nuk është paraparë ndryshe.
4. Në rast barazimi votash, vendimtare është vota e kryesuesit të mbledhjes.
5. Në çdo pikë të rendit të ditës, kryesuesi e hap diskutimin, e hedh në votim dhe konstaton përmbajtjen dhe rezultatin e vendimit.
6. Në rast konflikti interesi, anëtari obligohet të vetëdeklarohet dhe të tërhiqet nga votimi. Në rast mosdeklarimi, rrethana mund të denoncohet nga çdo anëtar i KQZ-së.
7. Në rast denoncimi, kryesuesi e hedh në votim denoncimin e arsyetuar.
8. Kur konstatohet konflikt interesi, anëtari përjashtohet nga shqyrtimi dhe votimi i çështjes.

Neni 10

Votimi në mbledhje

1. Votimi në mbledhjet e KQZ-së është i hapur.
2. Votimi bëhet me: PËR, KUNDËR dhe ABSTENIM.
3. Vendimet e KQZ-së mund të merren edhe në procedurë qarkulluese.

4. Procedura qarkulluese është procedurë votimi me shkrim, ku anëtarët votojnë individualisht pa qenë e nevojshme mbledhja.

Neni 11

Detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretariatit të KQZ-së (SKQZ)

1. SKQZ është shërbim administrativ i KQZ-së që, në kuadër të funksioneve dhe përgjegjësi, e ndihmon KQZ-në në zbatimin e procesit zgjedhor në pajtim me këtë Rregullore dhe aktet e tjera normative të OIK.
2. SKQZ ushtron këto funksione:
 - 2.1. njofton anëtarët e KQZ-së për mbledhjet;
 - 2.2. përgatit dhe dërgon materialin e nevojshëm;
 - 2.3. merr pjesë në ekzekutimin e Planit të Veprimit;
 - 2.4. kryen veprime të besuara nga KQZ lidhur me procesin zgjedhor;
 - 2.5. ofron mbështetje logjistike për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor;
 - 2.6. koordinon shpërndarjen dhe mbledhjen e materialit zgjedhor sipas afateve të Planit të Veprimit;
 - 2.7. siguron mbajtjen e procesverbaleve dhe evidencën e pjesëmarrjes;
 - 2.8. kryen punë të tjera sipas nevojës.
3. SKQZ mund t'i propozojë KQZ-së çështje operationale dhe të propozojë që ato të shqyrtohen në mbledhje.

Neni 12

Përbërja e Sekretariatit të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve

1. Përbërja e SKQZ caktohet nga KQZ dhe nuk mund të ketë më shumë se dhjetë (10) anëtarë.
2. SKQZ është bartës i detyrave dhe përgjegjësi gjatë gjithë kohës sa zhvillohet procesi zgjedhor.
3. Këto dispozita zbatohen përshtatshëmrisht edhe gjatë organizimit të zgjedhjeve të parakohshme për ndonjërin nga organet e OIK.

Neni 13

Themelimi dhe përbërja e Komisionit të Njësive Zgjedhore

1. KNJZ ka tre (3) anëtarë, të cilët janë përgjegjës për administrimin dhe organizimin e zgjedhjeve brenda njësisë zgjedhore rajonale.
2. Në rast rrezikimi të mbajtjes së zgjedhjeve në një njësi zgjedhore, KQZ mund të emërojë KNJZ edhe nga anëtarë që nuk votojnë në atë njësi.
3. KNJZ-të certifikohen me vendim të KQZ-së në përputhje me afatin e caktuar në Planin e Veprimit.
4. KNJZ-të kanë mandat deri në certifikimin e rezultatit zgjedhor nga KQZ.
5. KQZ mund të nxjerrë akt të veçantë me të cilin përcakton kompetenca, përgjegjësi shtesë dhe funksione të tjera për KNJZ.
6. Emërimi i anëtarit të KNJZ i nënshtrohet betimit dhe nënshkrimit të Kodit të Sjelljes të miratuar për procesin zgjedhor, para fillimit të punës.

Neni 14

Kompetencat dhe përgjegjësitë e KNJZ-së

1. KNJZ ka kompetenca dhe përgjegjësi për:
 - 1.1. mbarëvajtjen e procesit zgjedhor në vendvotimin e njësisë zgjedhore;
 - 1.2. zbatimin e masave të përcaktuara nga KQZ për menaxhimin e procesit të votimit;
 - 1.3. kujdesin ndaj materialit zgjedhor dhe përdorimin e tij sipas rregullave të përcaktuara nga KQZ;
 - 1.4. shmangien dhe raportimin e parregullsive zgjedhore;
 - 1.5. organizimin e përgatitjeve teknike në vendvotim, përfshirë pranimin e materialit, kujdesin dhe dorëzimin e tij pas përfundimit të procesit; sigurimin e mbarëvajtjes së votimit dhe numërimit, si dhe përmbledhjen e rezultateve;
 - 1.6. kryerjen e punëve të tjera të përcaktuara nga KQZ;
 - 1.7. pranimin, ruajtjen dhe dorëzimin e materialit zgjedhor të pranuar nga KQZ;
 - 1.8. bashkëpunimin me drejtuesit e institucioneve që shërbejnë si njësi zgjedhore për sigurimin e ambienteve dhe logjistikës;
 - 1.9. vendosjen e informatave publike për zhvillimin e zgjedhjeve;
 - 1.10. shqyrtimin dhe vendosjen për kërkesat/ankesat verbale në kompetencë të tyre;
 - 1.11. mbikëqyrjen e përgatitjes së hapësirave të vendvotimit dhe ruajtjen e materialeve zgjedhore deri në përfundim;
 - 1.12. shpalljen e rezultateve preliminare në njësinë zgjedhore;
 - 1.13. ndarjen e detyrave administrative-teknike nga kryesuesi i KNJZ, në konsultim me anëtarët;
 - 1.14. dorëzimin e materialit zgjedhor në KQZ në ditën e zgjedhjeve jo më larg se ora 23:59, përveç nëse KQZ vendos ndryshe;
 - 1.15. respektimin e ligjit dhe rregullave zgjedhore gjatë ushtrimit të funksionit.
2. Në rast të shkeljeve të rregullave zgjedhore, KNJZ duhet ta informojë menjëherë KQZ-në dhe kandidatët/mbështetësit, në mënyrë që të merren masa korrigjuese brenda 48 orëve, kur është e mundur.

Neni 15

Paraqitja e propozimeve për anëtarë të Komisioneve të Njësive Zgjedhore

1. KQZ emëron sipas detyrës zyrtare anëtarët e KNJZ.
2. KQZ mund të kërkojë propozime nga institucioni shëndetësor që shërben si njësi zgjedhore për të deleguar tre (3) përfaqësues; njoftimi përmban ftesën për nominim dhe kriteret.
3. Institucionet shëndetësore, jo më larg se tre (3) ditë nga pranimi i njoftimit, i paraqesin nominimet në KQZ.
4. Lista e nominimeve përmban: emrin, mbiemrin, pozitën, numrin e licencës dhe të dhënat e kontaktit.
5. Nominimit/emërimit i bashkëngjitet dokumentacioni:
 - 5.1. letërnjoftimi;
 - 5.2. numri i llogarisë bankare;
 - 5.3. dëshmia mbi marrëdhënien e punës – kontrata e punës (nëse është në marrëdhënie pune).

Neni 16

Kualifikimi dhe kriteret për emërim në Komisionin e Njësive Zgjedhore

1. Personi i nominuar për anëtar të KNJZ duhet t'i plotësojë këto kriteret:
 - 1.1. të jetë i punësuar në njësinë përkatëse;
 - 1.2. të mos ketë dhënë nënshkrim mbështetës për asnjë kandidat për anëtar të Kuvendit;
 - 1.3. të mos jetë kandidat për anëtar të Kuvendit.

Neni 17

Papajtueshmëria e funksionit të anëtarëve të Komisionit të Njësive Zgjedhore

1. Anëtar i KNJZ nuk mund të caktohet të shërbejë ose të vazhdojë të shërbejë nëse ai/ajo është kandidat për anëtar të Kuvendit.
2. Anëtar i KNJZ nuk mund të caktohet nëse është në konflikt interesi për shkak të lidhjes familjare me ndonjërin nga kandidatët në njësinë zgjedhore ku është caktuar; konfliktin obligohet ta deklarojë para ushtrimit të funksionit.
3. Anëtar i KNJZ nuk mund të caktohet të shërbejë ose të vazhdojë të shërbejë nëse ka dhënë nënshkrim mbështetës për ndonjërin prej kandidatëve për anëtar Kuvendi nga ajo njësi zgjedhore.

Neni 18

Përfundimi i mandatit të anëtarit/es të Komisionit të Njësive Zgjedhore

1. Mandati i anëtarit të KNJZ përfundon:
 - 1.1. me përfundimin e mandatit;
 - 1.2. me revokim nga KQZ;
 - 1.3. me dorëheqje;
 - 1.4. me kërkesë të subjektit politik (nëse është e aplikueshme);
 - 1.5. me humbjen e kriterëve të emërimit;
 - 1.6. me vdekje.
2. Mandati i anëtarit të KNJZ përfundon pesëmbëdhjetë (15) ditë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, përveç nëse ndërpritet ose zgjatet me vendim para përfundimit të mandatit.
3. Anëtarit të KNJZ i revokohet emërimi me vendim të KQZ-së, nëse:
 - 3.1. nuk i kryen detyrat sipas rregullave;
 - 3.2. vepron në mënyrë të njëanshme dhe joprofesionale;
 - 3.3. nuk merr pjesë në dy (2) takime të njëpasnjëshme pa arsye të bazuar;
 - 3.4. ndërhyt në procesin zgjedhor;
 - 3.5. nuk paraqitet në detyrë dy (2) ditë radhazi pa arsye të qëndrueshme.
4. Kryesuesi i KNJZ mund të iniciojë kërkesë në KQZ për revokim të emërimit, nëse anëtari vepron në kundërshtim me rregullat zgjedhore dhe Kodin e Sjelljes.
5. KQZ vendos jo më vonë se dy (2) ditë pas pranimit të kërkesës për revokim.
6. KQZ mund t'i kërkojë institucionit shëndetësor që shërben si njësi zgjedhore të bëjë nominim të ri brenda tre (3) ditëve, kur i përfundon mandati anëtarit sipas paragrafit 1 nënparagrafët 1.2–1.5.
7. Anëtari i dorëhequr apo i shkarkuar i KNJZ obligohet t'i dorëzojë pajisjet e ngarkuara nga KQZ dhe KNJZ.
8. Paragrafët 1 dhe 3 të këtij neni zbatohen përshtatshëmrisht edhe për anëtarët e KQZ-së.

Neni 19

Zëvendësimi i anëtarëve në Komisionin e Njësisë Zgjedhore

1. Kur pozita e një anëtari të KNJZ mbetet e lirë, emërimi i anëtarit të ri bëhet nga KQZ brenda dy (2) ditëve.
2. Kur anëtari i KNJZ jep dorëheqje, deklarata e dorëheqjes i dorëzohet menjëherë KQZ-së.

Neni 20

Kompensimi i anëtarëve të Komisionit të Njësisë Zgjedhore

Anëtarëve të KNJZ u kompensohen mëditjet sipas vendimit të posaçëm të KQZ-së, si dhe shpenzimet ditore gjatë procesit të votimit, përfshirë shpenzimet e pranimit dhe bartjes së materialeve zgjedhore, në përputhje me vendimin e KQZ-së.

Neni 21

Dokumenti i identifikimit

1. Gjatë ushtrimit të detyrës, anëtarët e KNJZ janë të detyruar të mbajnë në mënyrë të dukshme dokumentin e identifikimit, të lëshuar nga KQZ.
2. Dokumenti i identifikimit përmban së paku: emrin dhe mbiemrin, pozitën zyrtare dhe të dhëna të tjera që përcaktohen nga KQZ.

Neni 22

Vendimmarrja në Komisionin e Njësisë Zgjedhore

1. KNJZ synon të vendosë me konsensus. Kur konsensusi nuk është i mundur, vendoset me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.
2. Anëtari i KNJZ mund të informojë KQZ-në për çdo çështje që e sheh të arsyeshme dhe që nuk ka mundur të zgjidhet në KNJZ.
3. Ndaj vendimeve të KNJZ, anëtari mund të parashtrojë ankesë në KQZ.

Neni 23

Materialet për informim publik

1. KNJZ, në koordinim me drejtuesit e institucionit shëndetësor që shërben si njësi zgjedhore, cakton vende të posaçme për ekspozimin e materialit të shtypur zgjedhor dhe materialit për informim publik, të përgatitur nga KQZ.
2. Vendet e tilla caktohen në hapësirat më të frekuentuara dhe më të dukshme në njësinë zgjedhore përkatëse.

Neni 24

Konflikti i interesit

1. Asnjë anëtar i KNJZ nuk mund të marrë pjesë në shqyrtim dhe vendimmarrje për çështje ku anëtari i familjes ka interes personal ose financiar, që mund ta vë në dyshim paanshmërinë e anëtarit.

2. Anëtari që ka konflikt interesi obligohet ta vetë deklarojë.
3. Asnjë anëtar i KNJZ nuk mund të pranojë, në emër të funksionit, çfarëdo kompensimi monetar apo material nga persona fizikë ose juridikë, përveç atyre të përcaktuara nga KQZ.
4. Konflikti i interesit interpretohet nga KQZ në frymën e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe rregullave zgjedhore të OIK.

Neni 25

Dokumentacioni

1. Kryesuesi i KNJZ është përgjegjës për arkivimin dhe sistemimin e dokumentacionit zgjedhor; krijon dosje të veçantë për vendimet dhe udhëzimet e KQZ-së dhe mban dosje për aktet e tjera të nxjerra nga KNJZ.
2. Format e shkresave të KNJZ janë unike dhe përpilohen nga KQZ.
3. Me kërkesë të kandidatëve, jepet kopje e akteve, në përputhje me rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 26

Shfrytëzimi i pajisjeve

KNJZ obligohet që të gjitha pajisjet e pranuar nga KQZ, për qëllim të kryerjes së funksioneve gjatë procesit zgjedhor, pas përfundimit të procesit, t'i kthejë në KQZ.

Neni 27

Ruajtja e dokumentacionit dhe pajisjeve

KNJZ obligohet që dokumentet e nxjerra, materialet zgjedhore dhe pajisjet zgjedhore, pas përfundimit të numërimit të votave ose jo më larg se afati i përcaktuar nga KQZ, t'i dorëzojë fizikisht për ruajtje në selinë e KQZ-së.

Neni 28

Dispozitat përfundimtare

Çështjet që lidhen me punën e KNJZ dhe që nuk janë të rregulluara me këtë Rregullore ose me aktet e tjera të OIK, rregullohen me vendim ose akt tjetër të KQZ-së, në frymën e kësaj Rregulloreje.

Neni 29

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit.

Prishtinë, _____



Kryetare e OIK

Nexhmije Gori